



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 12.04.2017

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “RAFINERI BITUMI”, ME**  
**VENDNDODHJE NË PARKUN ENERGJETIK DHE INDUSTRIAL, PORTO ROMANO,**  
**BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Albitumen” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rafineri Bitumi”, me vendndodhje në Parkun Energjetik dhe Industrial, Porto Romano, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Albitumen” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) konvertimit të zërit kadastral nga “arë” në “truell” sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
  - b) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve;
  - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

DREJTOR I AGJENCISE SE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

